PROCESVERBAL I MBLEDHJES DATE 30.09.2026

Sot, në sallën e mbledhjeve të KB Devoll zhvillohet mbledhja e radhës, sipas njoftimit të datës 24.09.2026.

Të pranishëm në sallë: Alfredi Gjata, Valbona Spaho, Imelda Çuçka, Oljana Comka, Festim Kaso, Trifon Meraku, Lindita Cokani, Vladimir Gjyli, Paola Spaho, Vladimir Kello, Elona Limka, Oliver Mulla.

Alfredi Gjata: A ka ndonjë nga këshilltarët konflikt interesi?

0 pro, 12 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Kemi një projekt-vendim i cili erdhi sot në lidhje me reformën territoriale. Për efekt kohe e futëm jashtë rendit të ditës. Jeni dakord?

ProjektVendim Nr.77 Datë 30.09.2026 Për dhenien e mendimit zyrtar mbi projektligjin "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të veteqeverisjes vendore në Republiken e Shqipërisë.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Vladimir Kello: Mosndryshimi i kufijve territorialë dhe qëndrimin e Bashkisë Devoll si njësi më vete administrative territoriale, këtu theksoj të fshatrat dhe ai fshat që na e kanë marrë, Dardhën. Më vjen mirë që çdo qytetar kërkon të drejtën e ligjshme që Bashkia Devoll të qëndrojë njësi më vete administrative.

Festim Kaso: Për sa i përket dhënies të mendimit për projektligjin, në përgjithësi për Bashkinë tonë si njësi më vete e vetëqeverisjes vendore jemi dakord. Nuk mund të shprehemi për dakordësi ose jo që ka të bëjë me njësitë e tjera.

Imelda Çuçka: Për sa kohë PV Nr. 77 e ka të përcaktuar që ne japim pëlqimin në kuadër të pikës 1 dhe 2, ne japim pëlqimin vetëm për Bashkinë Devoll.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 1. "Miratimi i rendit të ditës".

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2 "Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 27.08.2026".

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 3, Projektvendim Nr. 62 datë 17.07.2026 "Për miratimin paraprak e planit të menaxhimit të pyjeve bashkiak të ekonomisë pyjore "Qafa e Zvezdës-Trestenik."

Për këtë PV nuk ka diskutime pasi u shty për nga komisioni.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4, Projektvendim Nr. 69 datë 23.09.2026 Për dhënien me qira të sipërfaqes 120 HA në ngastrat me kod kadastral KO02 00 010, 013, 015, në ekonominë kullosore "Bilisht" (Për prodhimin e energjisë të rinovueshme nëpërmjet paneleve fotovoltaike.)

Eduard Duro: Për këtë sipërfaqe nuk është se kemi një të interesuar konkret, por është hapi paraprak që ne bëjmë para se ta japim me qira. Është tokë e përshtatshme për panele fotovoltaike.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 5, Projektvendim Nr. 70 datë 23.09.2026 Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok ndihmën ekonomike për muajin Gusht 2026.

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 6, Projektvendim Nr. 71 datë 23.09.2026 Për një ndryshim me Vendimin Nr.65 datë 23.09.2025 "Për caktimin e përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore në bordet e institucioneve arsimore

Eliverta Pavliqoti: Këtë vit kemi ndryshime në bordin e institucioneve arsimore. Kemi 2 propozime, Erjon Palani dhe Vladimir Kello.

Imelda Çuçka: Fatmirësisht, z. Vladimir Kello ka qenë pjesë e institucioneve tona shkollore dhe e ka bërë më së miri detyrën, korrekte në mënyrën e përfaqësimit të Bashkisë Devoll në institucionet shkollore, sepse korrektësinë e ka të karakterizuar që në procesin ku bënte pjesë si mësues, si qytetar, ku për mua ka vlerësim maksimal. Pas daljes në pension, para 2 vitesh, për ne ka qenë humbje e madhe, sepse nxënësit tanë, për lëndët që ai mbulonte, kanë reflektuar edhe nëpër olimpiada. Jam e bindur që profesori do ta përfaqësojë denjësisht KB, në bordin e institucioneve shkollore.

Elona Limka: Pa i hequr asnjë presje fjalëve të Imeldës, unë do të shtoja që në përvojën time si drejtuese e institucionit, bordi ka një rol shumë të rëndësishëm, por fatkeqësisht kushdo që ka ardhur si përfaqësues i pushtetit vendor, nuk e ka bërë punën si duhet. Shkollat kanë problematika të ndryshme, të cilat lidhen me infrastrukturën, sektori i shërbimeve p.sh., problematikat i di, por kur ngremë zërin ne, përfaqësuesi i Bashkisë duhet të jetë më kërkues: higjena, siguria etj. Mendoj që profesor Vladimir Kello do të jetë një përfaqësues i denjë.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 7, Projektvendim Nr. 72 datë 23.09.2026 Për miratimin e projektit të fazës së dytë të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 – i rishikuar.

Aurela Furxhi: Për PBA janë përditësuar te gjitha levizjet buxhetore te cilat kanë shtrirje buxhetore 3-vjecare, duke ulur shpenzimet operative dhe rritur investimet.Pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me PV e tjera,qe nuk janë në rendin e ditës.

Projektvendim Nr. 73 Datë 29.09.2026 Per miratimin e aplikimit dhe bashkefinancimit te projektit me titull:"caves and sacred landscapes: a cross-border route in prespa" (Caves of Prespa) dhe ProjektVendimi Nr. 74 Datë 29.09.2026 " Per miratimin e aplikimit dhe bashkefinancimit te projektit me titull:"cross-border litter prevention, ecosystem action and reporting" (Prespa Clear)"

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me ProjektVendimin Nr. 75 Datë 29.09.2026 "Për miratimin dhe perdorimin e fondit te emergjencave civile."

Aurela Furxhi: Me vendimin e Keshillit te Bashkise nr.75 date 22.07.2026 " Per rishperndarjen e fondeve te Buxhetit te Vitit 2026" eshte miratuar fondi per punimet e objektit " Sistemim kanali sekondar fshati Proger"
Si projekt i plote kanali kushton ne vleren 12,637,094 leke, vlera e punimeve u miratua me vendimin nr.75 date 22.07.2026. Vlera e materialeve shkon 4.372.356 leke. Me shkresen nr.nr.2700 date 09.07.2026 prane Ministrise se Mbrojtjes eshte kerkuar te kalohet fondi per projektin 91707AG per shpenzime ne vleren 4.372,356 leke levizje e kryer tashme.
Kerkojme nga ana juaj miratimin per perdorimin e fondit te kushtezuar per vijimin e projektit Sistemim kanali sekondar fshati Proger.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata : Vazhdojmë me ProjektVendimin Nr. 76 Datë 29.09.2026 Për miratimin e një ndryshimi në listen e inventarit të pronave të paluajtshme të Bashkisë Devoll, miratuar me VKM-Nr.764 datë 07.11.2012" Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bilisht, të Qarkut të Korçës.

Erjon Rado: Këto janë disa pasuri që ndodhen në gurët e zinj afër xhamisë në Bilisht me sipërfaqe 23000 m2 që me VKM e vitit 2012 janë kaluar ne perdorim te bashkise dhe me

ligjet e tanishme duhet të kalohen në përdorim , në pronësi të Bashkisë për tu perdorur më vonë sipas ligjeve në fuqi.

Alfredi Gjata: Kemi 2 kërkesa për propozime për qytetar nderi: z. Sinan Agolli dhe Bashkim Gjoza.

Lexohen kërkesat.

Vladimir Kello: Z. Bashkim Gjoza ka qenë një qytetar i devotshëm, i cili nuk e ka kursyer as veten e tij, por është përkushtuar interesave të këtij qyteti. Jo vetëm në fushën e artit, të kulturës, po edhe një njeri aktiv i shoqërisë civile.

Eduard Duro: Këto janë kërkesa jo domosdoshmërisht për qytetar nderi, por edhe emra rruge, sheshi, kullë etj.

Alfredi Gjata: Propozimet për "Dhënien e titullit Qytetar Nderi" paraqiten nga: kryetari i Bashkisë, çdo anëtar i KB, prefekti i Qarkut. Unë mendoj që kur të bëhen emrat e rrugëve, të mbeten këto opsione që kemi. Nuk qëndrojnë nga ana juridike këto kërkesa.

Alfredi Gjata: Kemi dhe Raport për monitorimin e zbatimit të buxhetit 8-mujor të vitit 2026.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Tek pika të tjera:

Trifon Meraku: Kemi miratuar një vendim për dhënien e titullit qytetar nderi për z. Ridvan Bode, para 6 muajsh dhe po të drejtohem ty, kryetar i këshillit, pse nuk po zbatohet.

Alfredi Gjata: Përgjigjen ta kam dhënë, sipas ligjit titullin e jep Kryetari i Bashkisë, në raste festash sipas gjykimit të tij.

Trifon Meraku: Mendoj që kjo nuk duhet të zgjatet kaq shumë. Unë e di kush i ka kompetencat, por duhet parë se ka mbetur pa zgjidhje, po ju drejtohem përsëri ju. Mendoj që është personale.

Gjithashtu me këndin e lojërave, është miratuar një fond në dijeninë tone. Do bëhet? S'do bëhet?

Eduard Duro: Prokurimi për këndin e lojërave përfundoi në muajin maj. Një subjekt joaplikues e kishte ankimuar në APP, u kthye procedura nga e para. Besoj shumë shpejt do të ribëhet publikimi për prokurimin nga e para.

Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Protokolluesi:
Kostandina Brahdli

kryetari i këshillit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL